



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 1450/4 Prot.

Fier, më 09.12.2021

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve Nr. 93 dhe Nr. 94 të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen e datës 25.11.2021.

Drejtuar: Znj. Majlinda **BUFI**
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC

Z. Kadri **HYSKA**
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

ROSKOVEC

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 8017 Prot. datë 26.11.2021, protokolluar me tonën me nr. 1450 prot. datë 03.12.2021 bazuar në Ligjin Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" neni 16 si dhe në Ligjin Nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative*" neni 3 pika 2, shqyrtoam ligjshmërinë e vendimeve me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuara në mbledhjen datës 25.11.2021, shoqëruar me dokumentacionin plotësues për vendimet dhe procesverbalin e mbledhjes Nr. 12 datë 25.11.2021, si më poshtë:

Vendimi nr. 93 datë 25.11.2021 "Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2022", shoqëruar nga projekt vendimi nr. 93 datë 19.11.2021 protokolluar me nr. 7823 prot datë 19.11.2021, relacioni shpjegues nr 7823/1 prot. datë 19.11.2021, procesverbalet e këshillimeve publike

Është në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) neni 8 pika 2; neni 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja "b" dhe neni 54 shkronja "f"; Ligjin Nr. 9936 Datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 9632, Datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"(i ndryshuar); Ligjin Nr.68 Datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" kreu III , Ligjin 9975 datë 28/07/2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 10296 Datë 08/07/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9920 Datë 19/05/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar); Ligjin Nr. 10081 Datë 23/02/2009 "Për licencat autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjin Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"(i ndryshuar); Ligjin Nr.8450 datë 24/02/1999 "Për përpunimin transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" (i ndryshuar); VKM Nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave"; Ligjin Nr. 10465 datë

29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"; Ligjin Nr. 8098 datë 23.03.1996 "Për statusin e të verbërit" (i ndryshuar); Ligjin Nr.8626 datë 22.06.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" (i ndryshuar); Ligjin Nr 7889, datë 14.12.1994 "Status i invalidit" (i ndryshuar); VKM nr.132, datë 7.3.2018 për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" (i ndryshuar)

Vendimi nr. 94 datë 25.11.2021 "Per miratim fondesh shtesë në Buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2021" shoqëruar nga projekt vendimi nr. 94 datë 19.11.2021 protokolluar me nr. 7821 prot. datë 19.11.2021, relacioni shpjegues nr. 7821/1 prot datë 19.11.2021 Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja "b", neni 54 gërma "dh". Ligjin Nr 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore" neni 22; Ligjin Nr 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetore në RSH" i ndryshuar neni 15; si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Lefter SHEHAJ

